



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosoves
www.uaj-gjilan.net, tel : 0280390112

Ref. nr. 02/680 Datë . 24 / 09 / 2021

Në mbështetje të nenit 23 pika 1.3 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, Këshilli Drejtues në mbledhjen XXII, të mbajtur më 19.03.2021, miraton këtë:

**RREGULLORE PËR ANGAZHIMIN E STUDENTËVE NË PUNË PRAKTIKE NË
ADMINISTRATËN E UNIVERSITETIT PUBLIK "KADRI ZEKA", GJILAN**

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është promovimi, aftësimi dhe avancimi profesional i studentëve dhe të posadiplomuarve, bazuar në nevojat e tregut të punës, në fushat që lidhen me departamentet dhe njësitë akademike në Universitetin Publik "Kadri Zeka", Gjiilan.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo rregullore rregullon formën e angazhimit të studentëve në punë praktike në administratën e Universitetit Publik "Kadri Zeka", Gjiilan.

Neni 3

Kohëzgjatja e punës praktike

Punën praktike studentët e kryejnë në administratën e Universitetit Publik "Kadi Zeka", Gjilan dhe zgjat deri në tre muaj (3 muaj), me mundësi të zgjatjes edhe për një tremujorësh të dytë.

Neni 4

Kriteret për përzgjedhjen e studenteve për punë praktike

1. Përzgjedhja e studentëve do të bëhet nëpërmjet konkursit publik, që shpallet nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm në ueb faqen e UKZ-së, në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. Konkursi shpallet brenda muajit shtator.
3. Vlerësimin e dosjeve të kandidatëve, të cilët paraqiten në konkurs do ta bëjë komisioni profesional i themeluar nga Këshilli Drejtues në përbërje: Sekretari i Përgjithshëm-kryetar, një anëtar i KD, një anëtar nga stafi akademik, një anëtar nga administrata dhe një përfaqësues nga Parlamenti studentor.
4. Në përzgjedhjen e studentëve për punë praktike do të merret parasysh nota mesatare gjatë studimeve bachelor dhe master, njohja e gjuhës angleze, njohja dhe përdorimi i teknologjisë informative dhe aktiviteti në shërbim të komunitetit studentor e akademik.
5. Studentët që përzgjidhen për të kryer praktiken duhet të jenë studentë të vitit të fundit të studimeve (për nivelin bachelor) në UKZ ose të jenë të regjistruar në studimet master në UKZ. Kandidatet nuk duhet të kenë vite të përsëritura të studimeve.

Neni 5

Periudha e angazhimit, numri dhe sistemimi

1. Universiteti Publik "Kadri Zeka" Gjilan, në bazë të konkursit publik do të angazhojë në punë praktike deri në 20 studentë në vit akademik.
2. Sistemimi i praktikantëve bëhet nga Departamenti i Administratës, në koordinim me Sekretarin e Përgjithshëm.

3. Praktikantët do të sistemohen sipas nevojave në të gjitha departamentet e administratës së Universitetit Publik "Kadri Zeka", Gjilan.

Neni 6

Rregullimi i punës praktike

1. Studentet e përzgjedhur për punë praktike duhet të nënshkruajnë deklaratën e etikes, si dhe kontratën e angazhimit me Universitetin Publik "Kadri Zeka", Gjilan, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e tyre.
2. Periudha e angazhimit në punë praktike zgjat tre (3) muaj, mund të jetë me pagesë, sipas mundësive buxhetore të Universitetit Publik "Kadri Zeka", Gjilan dhe vendimit të Këshillit Drejtues.
3. Në fund të periudhës së angazhimit, Sekretari i Përgjithshëm, nëse praktikantët mbajnë praktikë në Administratën Qendrore dhe Sekretari i Fakultetit, nëse praktikantët mbajnë praktike në fakultete bëjnë vlerësimin e punës së praktikantëve, sipas rekomandimeve të udhëheqësve të departamenteve, ku janë angazhuar praktikantët dhe bazuar në këtë vlerësim, lëshohen certifikata për punët praktike të kryera nga studentët.
4. Praktikantët e angazhuar iu nënshtrohen Statutit, rregulloreve dhe të gjitha akteve të nxjerra nga Universiteti.
5. Në rast të veprimeve që bien në kundërshtim, me paragrafin 4 të këtij neni, Universiteti rezervon të drejtën për shkëputjen e kontratës.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryesues i Këshillit Drejtues


MSc. Ibrahim Kosumi